

# Statistikat e Krimeve

## Tremujori i tretë 2017


**Tiranë, më 18 Tetor 2017:** Në tremujorin e tretë 2017 janë kryer 9.900 vepra penale, rreth 10,3 % më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 10.068 autorë të veprave penale, të cilët janë 23,8 % më shumë krahasuar me tremujorin e tretë 2016.

Pjesën më të madhe të veprave penale e zënë “*Krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike*” me 40,3 %, “*Krimet kundër autoritetit të shtetit*” me 38,3 %, dhe “*Krimet kundër personit*” me 19,0 %.

**Tab. 1 Veprat penale dhe autorët**

Grupveprat penale	Vepra të evidentuara		Autorë	
	T3 - 2016	T3 - 2017	T3 - 2016	T3 - 2017
Krime kundër njerëzimit	0	0	0	0
Vepra penale kundër personit	1785	1,884	2039	2,212
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	2720	3,993	2283	3,506
Vepra penale kundër mjedisit	41	107	44	123
Krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues	0	1	0	1
Krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera	0	0	0	0
Aktet terroriste	7	5	6	3
Krime kundër autoritetit të shtetit	4334	3798	3633	4,093
Vepra penale kundër drejtësisë	88	110	112	130
Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve	0	0	0	0
Vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale	2	2	12	0
<b>Gjithsej</b>	<b>8,977</b>	<b>9,900</b>	<b>8,129</b>	<b>10,068</b>


**Fig.1 Veprat penale dhe autorët**



**Vepra penale kundër personit**

Gjatë tremujorit të tretë 2017 janë kryer 1.884 vepra penale kundër personit, duke pësuar rritje me 5,5 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2016. Numri i autorëve të krimeve kundër personit, në këtë periudhë është 2.212 dhe përbën 22,0 % të totalit të autorëve. Gjatë tremujorit të tretë 2017, numri i autorëve të kësaj vepre penale është rritur me 8,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


**Fig. 2 Veprat penale dhe autorët kundër personit**



### Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Në tremujorin e tretë 2017 janë kryer 3.993 vepra penale “*Krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike*”, duke pësuar rritje me 46,8 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2016. Autorët e tyre janë 3.506, rreth 53,6 % më shumë se në të njëjtën tremujor të një viti më parë dhe përbëjnë 34,8 % të totalit. Në këto vepra penale, *Vjedhjet e pasurisë* zënë 36,4 % të totalit. Krahasuar me tremujorin e tretë 2016, gjatë këtij tremujori vjedhjet e pasurisë kanë pësuar rritje me 3,3 %.

Fig. 3 Veprat penale dhe autorët kundër pasurisë dhe sferës ekonomike




### Veprat penale kundër autoritetit të shtetit

Në tremujorin e tretë 2017 janë kryer 3.798 vepra penale, me një rënie prej 12,4 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2016. Numri i autorëve gjatë tremujorit të tretë 2017, është 4.093, duke shënuar një rritje me 12,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, përbëjnë përqindjen më të madhe të veprave kundër autoritetit të shtetit, me rreth 78,7 %, duke regjistruar një ulje prej 19,6 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


**Fig. 4 Veprat penale kundër autoritetit të shtetit**



**Masat e sigurisë**

Gjatë tremujorit të tretë 2017, numërohen 10.068 masa sigurie për autorë të veprave penale, nga 8.129 që ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke pësuar rritje me 23,9 %.

**Fig. 5 Masat e sigurisë të ndërmarra për autorët e veprave penale**



**Tab. 2 Veprat penale kundër personit**

Vepra penale kundër personit	Vepra të evidentuara		Autorë	
	T 3 - 2016	T 3 - 2017	T 3 - 2016	T 3 - 2017
<b>Krime kundër jetës</b>	<b>431</b>	<b>391</b>	<b>473</b>	<b>437</b>
<i>Vrasje</i>	21	13	28	14
<i>Vrasje nga pakujdesia</i>	3	1	4	1
<i>Vrasje mbetur tentativë</i>	39	38	44	53
<i>Kanosje serioze për hakmarje ose gjakmarrje</i>	1	0	2	0
<i>Kanosja</i>	367	339	395	369
<b>Kundër shëndetit</b>	<b>325</b>	<b>370</b>	<b>405</b>	<b>484</b>
<i>Plagosje e lehtë me dashje</i>	290	326	355	431
<i>Mjekim pakujdesshëm</i>	3	4	7	3
<i>Të tjera</i>	32	40	43	50
<b>Krime seksuale</b>	<b>37</b>	<b>40</b>	<b>37</b>	<b>36</b>
<i>Tentativë mardhënie seksuale</i>	4	2	4	2
<i>Të tjera</i>	33	38	33	34
<b>Vepra penale kundër lirisë së personit</b>	<b>15</b>	<b>24</b>	<b>20</b>	<b>28</b>
<i>Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë</i>	9	6	10	8
<i>Trafikimi i personave</i>	5	13	9	13
<i>Përdorimi i shërbimeve nga persona të trafikuar</i>	0	3	0	4
<i>Të tjera</i>	1	2	1	3
<b>Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit</b>	<b>27</b>	<b>23</b>	<b>38</b>	<b>29</b>
<i>Ushtrim prostitucioni</i>	5	4	8	7
<i>Shfrytëzim prostitucioni</i>	18	15	26	14
<i>Mbajtja e lokaleve për prostitucion</i>	4	4	4	8
<b>Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes</b>	<b>434</b>	<b>523</b>	<b>462</b>	<b>555</b>
<i>Trafikimi i të miturit</i>	4	7	4	5
<i>Dhuna në familje 130/a</i>	403	424	430	457
<i>Të tjera</i>	27	92	28	93
<b>Vepra penale kundër lirisë së besimit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Të tjera kundër personit</b>	<b>516</b>	<b>513</b>	<b>604</b>	<b>643</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>1,785</b>	<b>1,884</b>	<b>2,039</b>	<b>2,212</b>

**Tab. 3 Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike**

Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	Vepra të evidentuara		Autorë	
	T 3 - 2016	T 3 - 2017	T 3 - 2016	T 3 - 2017
<b>Vjedhje pasurie</b>	<b>1,406</b>	<b>1,453</b>	<b>952</b>	<b>946</b>
<i>Vjedhje banke</i>	2	0	5	0
<i>Tentativë vjedhje banke</i>	0	1	0	2
<i>Vjedhje banese</i>	336	278	152	104
<i>Vjedhje kompanie firme</i>	4	9	5	5
<i>Vjedhje lokale tregtie</i>	122	89	63	75
<i>Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën</i>	21	28	20	33
<i>Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike</i>	217	265	218	272
<i>Vjedhja me dhunë</i>	22	32	29	17
<i>Vjedhje me dhunë mbetur tentativë</i>	9	3	12	0
<i>Trafikimi i mjeteve motorike</i>	42	58	40	57
<i>Tentativë vjedhje</i>	82	85	60	60
<i>Vjedhje me armë</i>	4	4	0	3
<i>Vjedhje me armë mbetur tentativë</i>	0	1	0	1
<i>Vjedhje me pasojë vdekjen</i>	0	0	0	0
<i>Trafikim i veprave të artit</i>	0	1	0	1
<i>Vjedhje automjetesh</i>	78	101	22	22
<i>Vjedhje të tjera</i>	467	498	326	294
<b>Mashtrimet</b>	<b>170</b>	<b>212</b>	<b>178</b>	<b>243</b>
<i>Mashtrime</i>	156	176	163	198
<i>Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit</i>	1	0	1	0
<i>Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale</i>	13	36	14	45
<b>Shkatërrimi i pronës</b>	<b>283</b>	<b>504</b>	<b>225</b>	<b>338</b>
<i>Shkatërrimi i pronës me zjarr</i>	56	219	23	85
<i>Shkatërrimi i pronës me eksploziv</i>	8	14	3	1
<i>Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera</i>	219	271	199	252
<b>Vepra në lidhje me ushtrim të palicensuar të veprimtarive bankare dhe financiare</b>	<b>6</b>	<b>16</b>	<b>6</b>	<b>16</b>
<b>Krime në fushën e doganave</b>	<b>34</b>	<b>77</b>	<b>26</b>	<b>88</b>
<i>Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve</i>	2	8	2	8
<i>Të tjera në fushën e doganave</i>	32	69	24	80
<b>Veprat në lidhje me tatimet dhe taksat</b>	<b>96</b>	<b>286</b>	<b>96</b>	<b>318</b>
<b>Veprat në fushën e fallsifikimeve</b>	<b>229</b>	<b>296</b>	<b>273</b>	<b>325</b>
<i>Fallsifikimi i leternjof.pasaportave, vizave</i>	35	85	39	89
<i>Të tjera në fushën e fallsifikimeve</i>	194	211	234	236
<b>Vepra penale që çënojnë regjimin juridik</b>	<b>286</b>	<b>862</b>	<b>309</b>	<b>930</b>
<i>Ndërtimi i paligjshëm</i>	286	862	309	930
<b>Të tjera kundër pronës dhe në sferën ekonomike</b>	<b>210</b>	<b>287</b>	<b>218</b>	<b>302</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>2,720</b>	<b>3,993</b>	<b>2,283</b>	<b>3,506</b>

**Tab. 4 Veprat penale kundër autoritetit të shtetit**

Krime kundër autoritetit të shtetit	Vepra të evidentuara		Autorë	
	T 3 - 2016	T 3 - 2017	T 3 - 2016	T 3 - 2017
<b>Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore nga shtetasit</b>	<b>484</b>	<b>646</b>	<b>666</b>	<b>815</b>
<i>Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik</i>	104	152	118	171
<i>Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik</i>	189	211	235	274
<i>Në fushën e korrupsionit</i>	191	283	313	370
<b>Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike</b>	<b>3,719</b>	<b>2,991</b>	<b>2,817</b>	<b>3,105</b>
<i>Trafikimi i armëve dhe i municionit</i>	5	4	12	2
<i>Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive</i>	1	0	1	0
<i>Prodhimi dhe shitja e narkotikëve</i>	283	412	365	463
<i>Trafikimi i narkotikëve</i>	34	42	46	43
<i>Kultivimi i bimëve narkotike</i>	1,260	142	243	100
<i>Të tjera në fushën e drogës</i>	4	11	5	11
<i>Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>	73	83	89	97
<i>Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor</i>	618	685	609	686
<i>Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi</i>	693	832	698	840
<i>Largimi nga vendi i aksidentit</i>	93	96	59	65
<i>Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit</i>	4	8	6	28
<i>Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit</i>	259	274	283	295
<i>Vepra në fushën e teknologjisë</i>	35	53	14	14
<i>Të tjera kunder rendit dhe sigurisë</i>	357	349	387	461
<b>Vepra penale kundër sekretit dhe kufijëve shtetëror</b>	<b>131</b>	<b>161</b>	<b>150</b>	<b>173</b>
<i>Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror</i>	113	145	118	155
<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>	18	16	32	18
<b>Gjithsej</b>	<b>4,334</b>	<b>3,798</b>	<b>3,633</b>	<b>4,093</b>

**Tab. 5 Masat e sigurisë të ndërmarra për autorët e veprave penale**

	Masat e sigurimit	
	T 3 2016	T 3 2017
Arrestuar	2,406	2,434
Ndaluar	515	424
Gjykim i lirë	4,487	6,570
Larguar	703	619
Të ndryshime	18	21
<b>Gjithsej</b>	<b>8,129</b>	<b>10,068</b>

# Metodologjia

Statistikat e krimeve pasqyrojnë të dhëna mbi veprat penale të evidentuara dhe personat e dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Grupimi i veprave penale është bërë sipas ndarjes referuar Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, respektivisht në 11 kapituj dhe duke u ndalur në seksionet e çdo kapitulli, ku janë evidentuar vepra penale gjatë tremujorit të tretë të vitit 2017 dhe 2016.

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara i referohen artikujve të Kodit Penal dhe jo ngjarjes, pasi në një ngjarje mund të gjejmë më shumë se një element kriminal të veprës penale.

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, jo në gjykime të cilat janë në kompetencat e organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin. Të dhënat mbi autorët gjithashtu përfshijnë edhe të dhëna mbi masat e sigurimit. Këto masa sigurimi i'u nënshtrohen personave në qoftë se në ngarkim të tyre ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.

## **Përkufizime:**

**Vepra penale:** Veprat me të cilat çënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundravajtje penale.

**Vepra penale kundër personit:** Përfshihen veprat penale kundër jetës, shëndetit, lirisë, moralit dhe dinjitetit, veprat penale kundër familjes, martesës, fëmijëve dhe kundër lirisë së besimit.

**Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike** përfshijnë vepra të tilla si: Vjedhjet e pasurisë, mashtrimet, krime në fushën e doganave dhe tatim-taksave, vepra që çënojnë regjimin juridik.

**Veprat penale kundër autoritetit të shtetit** përfshijnë vepra të tilla si: kundër veprimtarisë shtetërore nga shtetasit, kundër rendit dhe sigurisë publike si dhe kundër sekretit dhe kufijëve shtetëror, ku secili seksion përmban në vetvete një sërë aktesh të tjera.

**Autorë:** Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejon që të ndodh një vepër penale pra shkakton pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

**Vepra të raportuara:** vepra të raportuara në polici ose që policia ka njohuri mbi to në mënyra të tjera.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara dhe autorët janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.